



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 3 Prot

Tiranë, më 22.02 2008

VENDIM Nr. 1 dt. 20.02.2008

Në mbështetje të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.02.2008, pasi diskutoi pikën e parë të rendit të ditës mbi gjurmët dhe rrënojat arkeologjike që ndodhen në vazhdim të mureve ekzistuese të kalasë së Tiranës, Rruga "Murat Toptani"

VENDOSI

1. Të shpallë "Monument Kulture" gjurmët e reja të Kalasë së Tiranës. Ky vendim plotëson vendimin e vitit 1973, që shpall kalanë monument kulture. Në bazë të nenit 30 të ligjit 9048 "Për trashëgiminë kulturore" i ndryshuar, KKR i propozon Ministrin të MTKRS shpalljen e gjurmëve të kalasë Monument Kulture.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

PROF. DR. YLLI PANGO

SEKRETAR I K.K.R.

LORENC BEJKO